

“VICTORIA INVEST INTERNATIONAL” SH.P.K.

PERMBLEDHJA JOTEKNIKE

LEJA MINERARE NR.1677 dt.06.09.2013
Objekti “Mamez”, Qarku Kukës

KORRIK 2020

PERMBAJTJA

- a) Qellimi i veprimtarise dhe data e parashikuar e venies ne funksion te instalimeve
- b) Pershkrimi I vendndodhjes se veprimtarise shoqeruar me hartën perkatese
- c) Pershkrimi I proceseve teknologjike te veprimtarise
- d) Lloji, volume, konsumi dhe prodhimi I lendeve te para (shtojca I)
- e) Informacion I detajuar per shkarkimet ne mjedis (shtojca II)
- f) Informacion per cilesine e ajrit dhe ujrave siperfaqsores ne zonen e veprimtarise ku do te kryhen shkarkimet ne mjedis
- g) Pikat ku do te kruhen shkarkimet ne ajer dhe ku do te shkarkohen ujrat e ndotura. Keto pika duhet te pasqyrohen ne harte dhe shoqerohen me koordinata perkatese
- h) Rreziqet/aksidentet e mundshme ne mjedis te veprimtarise dhe nevoja per te parandaluar aksidentet, ose kur keto ndodhin per te minimizuar pasojat ne mjedis
- i) Masat per kapjen dhe trajtimin e ndotjes dhe shkarkimeve ne mjedis (Shtojca III)
 - Zbatimin e alternativave me te mira te disponueshme per parandalimin, ose reduktimin e shkarkimeve nga instalimet/impianti
 - Minimizimin/eliminimin e ndotjeve te kosideruar domethenese
 - Parandalimin e gjenerimit te mbetjeve ne perputhje me ligjin per menaxhimin e integruar te mbetjeve, ne rastet kur gjenerohen mbetje ato duhet te asgjeshohen per te evituar ose reduktuar impaktin ne mjedis
 - Perdorimin efcient te energjise, marrjen e te gjitha masave te nevojshme per te parandaluar aksidentet dhe minimizimin e impaktit te tyre
 - Marrjen e masave per te eliminuar rrezigjet e ndotjes dhe krijimin e kushteve te favorshme ne instalim/impiant, pas nderprerjes se funksionit te tij.
- j) Programi i vetemonitorimit te shkarkimeve ne mjedis (shtojca III)
- k) Plani i menaxhimit te mbetjeve ne perputhje me kerkesat e ligjit per menaxhimin e integruar te mbetjeve
- l) Planin e rehabilitimit per veprimtarite qe shfrytezojne burimet minerare sipas kerkesave te vendimit nr. 3 dt. 21/06/2006 te Keshillit Kombetar te Ujit dhe Udhezimit nr. 3 dt. 17/05/2006 "Per planet e rehabilitimit per siperfaqet e demtuara nga guroret"
- m) Planin e perballimit te emergjencave dhe aksidenteve me pasoje ne mjedis per veprimtarite qe perdorin, prodhojne dhe depozitojne lende te rrezikshme per mjedisin dhe shendetin e njerezve

a. Qellimi i veprimtarise dhe data e parashikuar e venies ne funksion te instalimeve

Ne kuadrin e ketij relacioni parashikohet shfrytezimi i rezervave te mineralit te nikel silikatit ne objektit te "Mamez", Komuna Kolsh, qarku Kukes, i cili parashikohet te filloje funksionimin pasi shoqeria te pajiset me leje minerare shfrytezimi nga Qendra Kombetare e Licensimit.

Ne relacion (projekt) do te percaktohet vendndodhja e veprimtarise, procesi teknologjik qe do te aplikohet, ndikimi ne mjedis per objektin minerar qe kerkohet te pajiset me leje mjedisore. Ne te pershkruhen ne menyre te hollesishme karakteristikat fizike te projektit, marrja ne konsiderate e alternativave, pershkrimi i karakteristikave te mjedisit qe mund te ndikohet, pershkrimi i ndikimeve te rendesishme te veprimtarise, parashikimi i ndikimeve indirekte, pershkrimi i masave per zbutjen e ketyre ndikimeve, programi i monitorimit, plani i rehabilitimit, plani i menaxhimit te mbetjeve etj...

b. Pershkrimi i vendndodhjes se veprimtarise shoqeruar me hartën perkatese

Objekti perben krahun perendimor te vendburimit te nikel – silikatit Mamez me keto koordinata gjeografike ; gjeresi veriore 42° 02' 44" deri 42° 03' 54" dhe gjatesi lindore 20° 22' 56" deri 20° 23' 44". Ndodhet ne Qarkun e Kukesit, komuna Kolsh rreth 2 km larg qytetit te Kukesit, mali me i larte eshte mali i Sukes me lartesi 826 m i cili ndodhet ne jugperendim te objektit te kerkuar per shfrytezim ne nje largesi rreth 1 km ne vije ajrore. Lidhet me rruge automobilistike rreth 6.5 km me rrugen nacionale.

Zona paraqitet kodrinoro – malore e lartesisve mesatare 400 – 450 m mbi nivelin e detit. Maja me e larte qe zoteron zonen eshte Suka e Mamezit me lartesi 826.6 m mbi nivelin e detit. Ne juge perendim te Mamezit kalon proji i Leshnices i cili veres ka nje prurje mesatare prej 0.1m³ \sek.ndersa dimrit arrin ne 4-6m³/sek.Rreth 500m me ne lindje ndodhet liqeni i Fierzes.

Klima e ketij rajoni eshte mesdhetare kontinentale me dimer te ashper dhe vere te fresket. Ka reshje te shumta shiu dhe bore.Temperaturat mesatare luhaten nga +20o deri ne +30o ne vere dhe ne dimer zbresin nga -100 deri -20o.Temperatura mesatare vjetore luhatet rreth 20o.Reshjet e debores si rregull fillonejne ne funde te Nendorit dhe vazhdojne deri ne Mars. Objekti ndodhet ne qarkun e Kukesit, komuna Kolsh dhe ben pjese ne hartën topografike te shkalles 1 : 25 000 me nomenklature K-34-65-D-c (Kalimashi) e kufizuar nga keto koordinata :

PIKAT	Y	X
1	4448000	4656005
2	4446250	4656605
3	4447200	4658105
4	4448000	4657955
5	4448000	4657655
6	4447300	4657755
7	4446700	4656755
8	4448000	4656305

Siperfaqja e zones se kerkuar per shfrytezim eshte **1.12 km²**.

Brenda zones nuk ka elemente te infrastruktures.

c. Pershkrimi i proceseve teknologjike te veprimtarise

- Rezervat qe merren parasysh ne projektim

Ne kapitullin e llogaritjes se rezervave eshte trajtuar menyra e llogaritjes se rezervave gjeologjike dhe e atyre qe merren parasysh ne projektim. Keto rezerva jane llogaritur 18810084 ton.

- Kushtet tekniko minerare te vendburimit

Nepermjet kompleksit te punimeve nentokesore , vrojtimit , dokumentimit e pergjithesimit te te dhenave , jane njohur kushtet tekniko-minerare te vendburimit , ne teresi dhe per çdo bllok ne veçanti. Kjo ndikuar ne shfrytezimin racional te rezervave.

• Hapja e minieres

Per zgjedhjen e variantit me te pershtatshem te hapjes e te shfrytezimit te vendburimit Mamez, kemi marre parasysh te gjitha faktoret qe influencojne ne percaktimin sa me te drejte te menyres se hapjes dhe te shfrytezimit te vendburimit qe ajo te jete jo vetem me tregues te mire tekniko-ekonomike, por edhe rentabel dhe me efektivitet te larte ekonomik, te realizohet nje koeficient prodhues prej 500 mije ton ne vit dhe me mundesi rritje te kapacitetit deri ne 1 milion ton ne vit.

Duke u nisur nga te dhenat gjeologo-minerare te vendburimit dhe shfrytezimin e tij jane pare dy variante:

- a) Hapja dhe shfrytezimi me punime nentokesore
- b) Hapja dhe shfrytezimi me punime siperfaqesore

Ne vendburimin e Mamezit trupi mineral paraqitet pothuaj ne gjithë siperfaqen e tij i mbuluar me kapele gelqerore e cila ka luajtur edhe rolin e ruajtjes te ketyre rezervave nga erozioni e faktore te tjere natyrore.

Sic eshte theksuar edhe me pare zona minerare eshte mjaft e shtrire e me dimensione te medha e vendosur ne nje teren pak a shume te sheshte, kodrinor dhe ruan nje shtrirje paralel me trupin mineral i cili shtrihet dhe zhytet ne menyre te qete e me thellesi qe shkon nga 4-10 deri 20 m.

Shfrytezimi me punime siperfaqesore i ka te gjitha mundesite qe te zbatohet persa i perket kushteve gjeologo-minerare te vendburimit, gjithashtu kjo menyre shfrytezimi ka avantazhet e veta teknike dhe ekonomike

- Sistemi i shfrytezimit

Kushtet tekniko minerare dhe gjeologjike te vendburimit te nikelsilikatit ne Mamez lejojne shfrytezimin e pjesshem me kariere te ketij vendburimi.

Trupat minerale kane vendosje gati horizontale si ne shtrirje dhe renie me dalje ne siperfaqe ose afer saj ne krahet veriore, lindore dhe jugore te vendburimit.

Per blloqet e marre ne studim koeficienti i zbulimit ne masiv arrin 0.9 m³/ton mineral.

Duke pare llojin e formacionit shkembor, qendrueshmerine dhe kompaktesine e tyre per anen minerare, kendi i pjerrtesise karieres eshte pranuar 70-72°, por mund te jete edhe me i madh ne pjese te vecanta te minieres.

Lartesia e shkalleve eshte parashikuar 10m, ndertimi i shkalleve te zbulimit do te filloje nga siper poshte, kendi i vogel nen 30° i relievit ben qe gjeresia e sheshit te cdo shkalle te jete jo me i vogel se 20 m. Kjo ben te mundur levizjen dhe manovrimin e paisjeve dhe makinerive pa veshtiresi. Me uljen poshte te zbulimit gjeresia e shkalleve te fundit arrin nga 60 m e larte.

Ne kariere sasia maksimale e shkalleve arrin deri ne 20 me nje lartesi te pergjithshme vertikale germimi qe arrin deri 190 m. (Kjo ne vartesi me relievin dhe pozicionin e ndodhjes se trupave minerare.

Rruget duhet te kene gjeresine e nevojshme per kalimin e makinave 30-40 toneshe dhe pajisjeve te tjera te renda si buldozere, ekskavatore, sonda etj. Transhete e rrugeve dhe fronteve te punes ne zbulim minimumi do te jete 6 ml.

Ne projektin teknik te detajuar te karieres, do te jepen relacionet, llogaritjet tekniko-ekonomike dhe gjithte materialit grafik te karieres ardhshme per nje prodhim 500 mije deri 1 milion ton ne vit.

Shfrytezimi i vendburimit me kariere siguron nje kosto me te ulet se shfrytezimi me punime nentokesore.

d. Lloji, volumi, konsumi dhe prodhimi i lendeve te para (shtojca I)

Lenda e pare e vetme qe do te prodhohet eshte minerali i nikel - silikatit dhe shkembenjve rrethues qe dalin gjate procesit te shfrytezimit. Per prodhimin e lendes se pare perdoren keto materiale ndihmese :

Materialet ndihmese	Njesia	Norma
Dinamit	kg/ton	0,25
Kapsolla	Cope/ton	0,8
Fitil	ml/ton	1,6

Ne procesin e prodhimit nuk perdoret perzierje materialesh,

Nuk perdoret lende djegese

Nuk perdoren kimikate sintetike apo laboratorike

SHTOJCA I - TE DHENA SPECIFIKE PER LENDET E PARA

Tabela 1, - Lendet e para

	PO	JO	Nese PO pershkruaj (tipin, sasine & burimin)
A perdorni lende te para	X		Lenda e pare qe prodhohet jane shkembenjte ultrabazik
A perdorni materiale ndihmese		X	
A perdorni perzierje materialesh		X	
A perdorni lende djegese (dhe/ose energji)		X	
A perdorni kimikate sintetike/laboratorike		X	
Lutemi rendisni materialet sipas volumeve qe do te perdoren			

Tabela 2 - Perdorimi/sigurimi I energjise

	PO	JO	Nese PO pershkruaj (tipin, sasine & burimin)
A perdoret energji		X	
A prodhohet kjo energji ne territorin e impiantit apo sigurohet nga burime te tjera		X	
Konsumi I lendeve djegese per sigurimin e energjise ne se prodhohet ne impiant/instalim		X	
Informacion tjetet sqarues		X	

Tabela 3_Konsumi i energjise dhe ujit

KONSUMI I ENERGIJE	Konsumi ditor dhe total ne baze viti (kwh/g, t/g e te ngjashme)
Burimi	–
Energjia elektrike	–
KONSUMI I UJIT	–
Burimi i furnizimit	–
Burimi i furnizimit	–

e. Informacion i detajuar per shkarkimet ne mjedis

SHTOJCA II - Te dhena specifike per shkarkimet ne mjedis dhe trajtimin e tyre

Gjate shfrytezimit ne kete objekt do te perdoret lenda plasese, per pasoje do te kemi shkarkime te gazrave dhe pluhurave ne mjedis. Theksojme qe keto shkarkime do te jene ne periudha te shkurtera kohe dhe ne varesi te shkalleve te shfrytezimit jo ne pozicione stabel. Tjeter burim qe shkarkon ne mjedis jane gazrat e krijuara nga ekskavatori dhe mjeti I transportit. Ne rastin e ketij projekti shkarkimet jane te paperfillshme brenda normave te lejuara, prandaj nuk do te trajtohen ne kete studim.

1, Shkarkimet ne mjedis dhe mbetjet

1,1, Shkarkimet ne ajer

Pyetje	PO	JO	Nese PO pershkruaj (tipin, sasine & burimin)
A ka shkarkime ne ajer (nga oxhaqet)		X	
A ka shkarkime ne ajer (nga burime te shperndara)	X		I vetmi burim qe shkarkon ne mjedis jane gazrat e krijuara nga ekskavatori dhe mjeti I transportit. Ne rastin e ketij projekti shkarkimet jane te paperfillshme brenda normave te lejuara
A ka erera te keqija nga shkarkimet		X	

1,2 Shkarkime te ujrave te ndotura

Pyetje	PO	JO	Nese PO pershkruaj (tipin, sasine & burimin)
A ka shkarkime te ujrave te ndotura		X	
A ka ujra te ndotura me natyre toksike		X	
A behen shkarkime ne rrjetin e kanalizimeve		X	
A behen shkarkime ne siperfaqet ujore		X	
Jepni sasine e ujrave te ndotura (m3/dite)			

1,3 Zhurma & Vibracionet

Pyetje	PO	JO	Nese PO pershkruaj (tipin, sasine & burimin)
A gjenerohen zhurma	X		Gjate procesit shperthimit, te ngarkimit dhe transportit gjenerohen zhurma vetem nga mjeti I ngarkimit dhe transportit per kohen qe ato jane ne pune. Keto zhurma jane brenda normave te lejuara

A gjenerohen vibracione		X	
-------------------------	--	---	--

1,4 Mbetjet e ngurta

Pyetje	PO	JO	Nese PO pershkruaj (tipin, sasine & burimin)
A gjenerohen mbetje te ngurta	X		Te vetmet mbetje te ngurta qe gjenerohen eshte masa e gjenerimit te dheut qe del nga zbulimi dhe mbetjet teknologjike per te cilat jane marre keto masa. Sheshi i depozitimit te mbuleses eshte parashikuar nen horizontin e fundit te shfrytezimit (kuota +540) me nje siperfaqe prej 110000 m ² . Ne kete shesh do te depozitohet per afate te shkurtera kohe edhe minerali. I rekomandojme shoqerise qe pjesen e dobishme te mbuleses qe mund te perdoret per shtrim rruges rurale ta transportoje direkt per ne destinacion sipas kontratave te lidhura paraprakisht nga ana e saj Në procesin e ngarkimit e shkarkimit te mineralit, në transport etj krijohet pluhur.
A gjenerohen mbetje te ngurta te rrezikshme		X	
Te asgjesuara ne territorin e impiantit/instalimit		X	

Normat e lejuara për pluhurat në ajrin e frymëmarrjes, pa përmbajtje SiO₂ është si më poshtë

Nr	Llojet e pluhurave	Përqëndrimi i lejuar i këtij lloje pluhuri në ajër në mg/m ³
1	Pluhur azbesti	2
2	Pluhur çimento-argjile	5
3	Pluhur qymyri	5
4	Oksid hekuri	5
5	Nikel dhe oksidet e tij	0.5

1,5, Burimet e shkarkimit ne ajer

Emertimi I shkarkuesit	
Pershkrimi	Burimi i vetem i shkarkimit ne ajer eshte mjeti i ngarkimit dhe ai i transportit, te cilet ndryshojne pozicionin e punes ne disa raste gjate dites.
Koordinatat	Frontet ne te cilat ndodhin keto shkarkime jane te ndryshueshme cdo dite, pra nuk jane stacionare dhe per rrjedhoje koordinatat e pikave te shkarkimit jane te ndryshueshme cdo dite.

Informacion per oxhakun	Ne rastin konkret nuk kemi te bejme me oxhak.
Diametri: Lartesia nga toka	
Data e venies ne pune	Data e venies ne pune eshte fillimi i punimeve te hapjes (marrija e lejes minerare) deri ne perfundimin e shfrytezimit

1,6 Fluksi dhe kohezgjatja e shkarkimeve (per cdo pike/burim shkarkimi) ne ajer

Rrjedha (volumi i shkarkuar)			
Vlera mesatare ne dite	N mg/d te paperfillshme	Max/dite te paperfillshme	Mg /d te paperfillshme
Vlera maksimale ne ore	N mg/ ore te paperfillshme	Rrjedha min te paperfillshme	m.s-1 te paperfillshme
Faktore te tjere	Nuk ka faktore te tjere ndikues		
Temperatura	°C(max) e ambientit	°C(min) e ambientit	°C(mes) e ambientit
Burimet e djegies	Nuk ka burime djegie		
Vlerat e volumit te dhena si :	___ l thate	___ l njome	___ % O2

1,7 Karakteristikat e shkarkimit ne ajer

Numri referues i pikes se shkarkimit. Sic e trajtuam edhe me siper frontet e punes ndryshojne disa here gjate 8 oreve, prandaj nuk mund te jepet nje nume referues i pikave te shkarkimit.

Parametri	Perpara trajtimit				Pershkrimi i shkurter i trajtimit	Pas trajtimit (filtra etj..)			
	mg/Nm ³		kg/ore			mg/Nm ³		kg/ore	
	Mes	Maks	Mes	Maks		Mes	Maks	Mes	Maks
-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
-	-	-	-	-	-	-	-	-	-

Jepni periudhen ose periudhat kur ndodhin shkarkimet duke perfshire variacionet ditore ose sezonale (jepni informacion se kur ka qene venia ne pune dhe/ose nderprejra e punes)

Kohezgjatja e shkarkimit (mesatare)	Min/ore	ore/dite	dite/vit
	-	-	-

1,8 Cilrimi i zhurmave ne mjedis

Zhurma ne ambient gjenerohen nga ekskavatori dhe makina e transportit per kohen qe ato jane ne pune, si edhe gjate shperthimit te minave. Ne rastin konkret keto jane te paperfillshme dhe meqenese qendrat e banuara jane ne distanca te largeta ato nuk krijojne shqetesime tek banoret. Persa i perket punonjesve, ata gjate ketyre proceseve do te jene te mbrojtur me syze, maska, kufje per te parandaluar shqetesimet e mundeshme qe mund te lindin gjate ekspozimit ndaj zhurmave e pluhurave.

Mjediset/Godinat e instalimit/impianitit	Sistemi koordinativ	Niveli i zhurmes dB(A)		
		L(A)	L(A)	L(A)
Vendndodhja 1	–	–	–	–
Vendndodhja 2	–	–	–	–
Vendndodhjet e ndjeshme te zhurmes				
Vendndodhja 1	–	–	–	–
Vendndodhja 2	–	–	–	–

2, Shkarkimet e ujrave te ndotur

1, Pika e shkarkimit

Nuk ka shkarkime te ujrave te ndotura.

Nr. Ref i pikes se shkarkimit (numri referues duhet te jete I njejte me numrin e shkruar ne harten e instalimit/impianitit)	
Burimi i shkarkimit	–
Vendndodhja	–
Koordinatat ne sistemin shteteror	–
Emri/Emertimi i marresit (lumi, liqenit)	–

2, Informacion i detajuar per shkarkimet e lengeta

Sasia e shkarkuar		Nuk ka shkarkime te tjera te lengeta	
Mesatare / dite	m ³	Sasia maksimale / ore	m ³
Sasia maksimale / ore	m ³	–	–

Jepni periudhen ose periudhat kur ndodhin shkarkimet duke perfshire variacionet ditore ose sezonale (jepni informacion se kur ka gene venia ne pune dhe/ose nderprejra e punes)

Periudha e shkarkimit (mesatare)	Min/ore	ore/dite	dite/vit
	Nuk ka shkarkime te lengeta		

3, Karakteristikat e shkarkimeve te ujrave te ndotura

Nuk ka shkarkime te ujrave te ndotura.

Parametri	Perpara trajtimit				Nga vendi I liritimit/leshimit pas shkarkimit			
	Mesatarja max. e vleres/ore (mg/l)	Mesatarja max. e vleres ditore (mg/l)	kg/dite	kg/vit	Vlera mesatare max. ne ore (mg/l)	Vlera ditore e mesatares max. (mg/l)	kg/dite	kg/vit
–	–	–	–	–	–	–	–	–

f. Informacion per cilesine e ajrit dhe ujrave siperfaqesore ne zonen e veprimtarise ku do te kryhen shkarkimet ne mjedis

Ajri eshte nje perzierje gazesh te azotit (78%), oksigjenit (21%), dioksidit te karbonit (CO₂) dhe te disa gazeve te tjere inerte. Ai, gjithashtu, permban avuj uji, sasia e te cilave ndryshon sipas gjereses gjeografike te zones, afersise se saj me siperfaqet ujore etj. Ajri permban dhe nje numer substancash te demshme.

Ndotja e ajrit kryesisht vjen nga trafiku I madh I makinave ne transportin rrugor qe eshte burim i rendesishem per leshimin e substancave te demshme ne ajer, siç jane: plumbi, benzeni, grimcat e imta dhe benzopireni. Pasojat jane paraqitja e smogut dhe koncentratet e shtuara te ketyre substancave ne ajer. Transporti rrugor shkakton, gjithashtu, me shume se gjysmen e shkarkimeve te NO_x dhe 35% te shkarkimeve organike te avullueshme Automjetet me motor nafte prodhojne grimca shume te imta, te cilat jane shume te demshme per shendetin e njeriut.

Ndotja e ajrit shkaktohet edhe nga industria e cila ne zonen e projektuar per shfrytezim dhe rajon nuk ekziston. Krahinat malore shfaqen si ishuj te ftohte me mjedisin rrethues te tyre. Temperatura e ajrit me e larte eshte ne muajt korrik – gusht dhe me e uleta ne janar – shkurt. Ecuria ditore e temperatures se ajrit shprehet nga nje lakore qe karakterizohet nga nje maksimum ne oret e para te pasdites dhe nje minimum para lindjes se diellit. Vlerat me te larta te lageshtise relative te ajrit vrojtohen ne gjysmen e ftohte te vitit dhe me theksuar ne muajt nentor, dhjetor, janar, ndersa vlerat me te uleta ne muajt korrik-gusht.

Per monitorimin e mikroklimës disponohen aparatura për testimin gazor , për matjen e temperatures, presionit, lagështirës relative, për matjen e shpejtësisë së lëvizjes së rrymave të ajrit, të eliminimit të pluhurave duke punuar me shpime të lagura etj.

g. Pikat ku do te kryhen shkarkimet ne ajer dhe ku do te shkarkohen ujrave te ndotura. Keto pika duhet te pasqyrohen ne harte dhe shoqerohen me koordinata perkatese

Sic u theksua edhe me lart nuk ka shkarkime te ujrave te ndotura apo shkarkime ne ajer.

h. Rreziqet/aksidentet e mundshme ne mjedis te veprimtarise dhe nevoja per te parandaluar aksidentet, ose kur keto ndodhin per te minimizuar pasojat ne mjedis

Gjate ushtrimit te ketij aktiviteti minerar, subjekti do te mbaje parasysh qe problemet mikroklimes e sigurimit teknik dhe te mbrojtjes ne pune te jene me te rendesishmet dhe me te mprehtat, qe kerkojne vleresim serioz.

Eshte e domsdoshme qe per drejtimin teknik te punimeve te aktivizohen specialiste te larte , me ekperience ne fushen e shfrytezimit te pllakoreve dhe mundesisht ta kene njohur zonen ne te cilen do te ushtrohet aktiviteti minerar.

Drejtuasi teknik i punimeve, para fillimit te punes dhe gjate saj , do te zbatoje rregullat dhe normat e percaktuara ne Regulloren e Teknikes se Sigurimit per Minierat dhe Karierat qe jane ne zbatim dhe Ligjit Minerar te Shqiperise Nr 10304, date 15.7.2010 dhe akteve nenligjore te tij

Regulloret e Teknikes se Sigurimit, nga ana e drejtuesit teknik te punimeve dhe subjektit privat, do te zbatohen ne cdo proces pune te percaktuar ne plan- organizimin e kryerjes se punimeve te hartuar nga drejtuesi teknik i punimeve dhe te miratuar nga drejtuesit e firmes , I cili duhet te permbaje :

- Plan organizimi i punimeve do te hartohet para fillimit te punimeve;
- Plan organizimi i punes hartohet nga drejtuesi teknik i punimeve;
- Drejtuesi teknik i punimeve, ose personi i ngarkuar, do te beje kontrollin teknik dhe azhornimin e sakte te punimeve minerare te cdo lloji per te cilat subjekti ka marre leje shfrytezimi;
- Rradha e kryerjes do te percaktohet hollesisht ne planin e masave tekniko-organizative dhe do te miratohete nga pronari i firmes;
- Ne kete plan tekniko-organizativ, masat e teknikes se sigurimit do te zene vendin kryesor .
- Drejtuesi teknik i punimeve do te kryeje instruksione te rregullta mujore e tre mujore , ku do te trajtohen tema te vecanta per te gjitha profesionet
- Punonjesit, qe do te punojne ne karriere per kontrollin e shpateve te shkalleve, shesheve te ngarkimit , rrugeve te transportit etj do te instruktohen rregullisht dhe do te ndjekin me rigorozitet zbatimin e rregullave dhr normave te Rr.T.S., qe lidhen me keto probleme .
- Kujdes i vecante do te tregohet ne krijimin e kushteve te punes , pastrimit te shesheve te shkalleve ,rrugeve te transportit, krefjes dhe skarifikimit te shpateve te shkalleve te punes dhe nenshkalleve sidomos kur punohet ne zonen me shkembinj me çarje.

Do te zbatohet nje regjim i rrepte ne aplikimin e pasaportave teknike te punimeve te ngarkimit dhe transportit te brendshem .

i. Masat per kapjen dhe trajtimin e ndotjes dhe shkarkimeve ne mjedis (Shtojca III)

- **Zbatimi i alternativave me te mira te disponueshme per parandalimin, ose reduktimin e shkarkimeve nga instalimet/impianti**

Procesi i perzgjedhjes se projektit, si dhe alternativat gjate hartimit te projektit/veprimtarise

Ne pershkrimin e projektit jane trajtuar hollesisht objektivat dhe karakteristikat fizike te projektit dhe bazat ligjore qe e ben te domosdoshem hartimin e tij.

Teknika dhe teknologjia e zhvillimit te punimeve te shfrytezimit mer parasysh parandalimin e rreziqeve ,mjedisore. Ne rastin konkret shfrytezimi do te behet me siperfaqe, gje qe minimizon shkarkimet ne ajer te pluhurave, zhurmave dhe gazrave, duke I bere ato te paperfillshme.

Ne projekt parshikohen zgjidhje teknike te punes ne raport me punonjesit qe do te punojne ne objekt dhe kalimtareve te zones. Me rritjen e numrit te punonjesve, shtimit te paisjeve teknologjike ndikimet ne mjedis do te trajtoheshin ne pershtatje me keto ndryshime.

- **Minimizimin/eliminimin e ndotjeve te kosideruar domethenese**

Per minimizimin/eliminimin e ndotjeve duhet te merren masat e nevojshme :

- Në minierë duhet te ndertohen dushet dhe garderobat, fjetoret dhe mensa për trajtimin ushqimor për punonjësit që flenë pranë minierës.
- Punonjësit që do lëvizin për në shtëpi pas punes duhet tu sigurohet transport falas.
- Punonjësit duhet te trajtohen me antidote (qumësht dhe fruta çdo ditë).
- Ujrat nga rreshjet atmosferike te largohen nga fronti I punes me system kanalizimesh ne konturet e karieres
- Niveli i zhurmave te fiksohen pranë makinerive.

Duke u larguar nga makinerite niveli i zhurmave bie. Tashmë dihet se veprimi i vazhdueshëm i zhurmës ç'rregullon ndigjimin, sistemin nervor, përkeqëson humorin dhe ul aftësinë për punë.

Në pamundësi të largohesh nga zhurma duke përdorur mjetet mbrojtëse si kufje dhe mjete mbrojtëse antifone.Kufjet ulin 30 % nivelin e zhurmave. Për zhurmat dhe vibracionet janë caktuar norma sanitare dhe instruksione manovrimi për ruajtjen e shëndetit.

Normat e ekspozimit në zhurmë gjatë punës,sipas Organizates Boterore të Shëndetit(O.B.SH.):

Kohëzgjatja e ekspozimit:

Niveli i zhurmes në dB:

8 orë	85 (maksimumi 90) dB
6 orë	92 dB
4 orë	95 dB
3 orë	97 dB
2 orë	100 dB
1-1.5 orë	102 dB
1 orë	105 dB
0.5 orë	110 dB
0.25 orë	115 dB

Punonjësit që janë të ekspozuar në zhurmë në nivelin nën 100 dB kalojnë në kontroll shendetësor për shkallë ndigjimi çdo vitë,ndersa për ekspozimet mbi 100 dB kontrolli bëhet çdo 6 muaj.

Për nivel zhurme mbi 85 dB aplikohet detyrimisht mbrojtje veshësh duke përdor mjete mbrojtëse(kufje,tampona etj),ndersa për nivel zhurme 90 dB e lart, kërkohet të merren masa mbrojtëse,për reduktimin e zhurmave.Ne kete rast koha e ekspozimit ne nje zhurme te tille eshte e rendit te 1-2 mili sekondave Niveli i zhurmave te krijuara per rastet b dhe c eshte i njejete

Rreziqe si pasoje e avarive te pajisjeve apo gjate proceseve

Avarite parashikohen vetem ne mekanizmat e instaluara , masat per eliminimin e te cilave jane trajtuar me siper.

- **Parandalimin e gjenerimit te mbetjeve ne perputhje me ligjin per menaxhimin e integruar te mbetjeve, ne rastet kur gjenerohen mbetje ato duhet te asgjesohen per te evituar ose reduktuar impaktin ne mjedis**

Sic u theksua me siper nuk gjenerohen mbetje nga procesi I prodhimit, ngarkimit dhe transportit.

Mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti jetesor i punetoreve apo ambalazhet do te grumbullohen neper thase te posaçem dhe do te transportohen drejt drejt qendrave me te aferta te banuara per menaxhim nga sektoret

perkates te pushtetit lokal. Gomat dhe vaji lubrifikant te perdoruar do t'u jepen subjekteve qe merren me riciklimin e tyre dhe qe aktualisht operojne edhe ne Shqiperi (Ministria e Mjedisit posedon nje liste te subjekteve riciklues)

SHTOJCA III - KAPJA DHE TRAJTIMI I NDOTJES DHE SHKARKIMEVE NE MJEDIS DHE MBETJEVE

1, Trajtimi i ndotjes

Lloji i shkarkimit/ndotjes (ne ajer, toke, uje)	Pershkrimi i trajtimit
Zhurmat dhe pluhurat	Manikerite duhet te mirembahen teknikisht qe zhurma e tyre te jete vetem ajo teknologjike dhe jo e avarive. Ato duhet te perdoren me eficence dhe te minimizohet koha gjate se ciles mbahen ndezur motoret. Skapamentot duhet te kene ne gjendje funksionale filtrat e tyre teknologjike te kapjes se grimcave (skapamentot e makinerive kane nje jastek te posatshem per kete gje). Do te perdoret nafta me permbajtje te ulet sqfuri. Transporti i materialeve te behet me mjete te pastra nga balta dhe te mbuluara nese rruget kalojne prane ose neper qendrat e banuara. Te menjahet renia e borive te automjeteve nga shoferet per te mos krijuar zhurme dhe stres tek banoret. Qarkullimi i kamioneve ne qendrat e banuara te behet me shpejtesi te ulet gje qe shmang jo vetem aksidentet por edhe krijimin e pluhurave..

- **Perdorimin eficient te energjise, marrjen e te gjitha masave te nevojshme per te parandaluar aksidentet dhe minimizimin e impaktit te tyre**

Sic u trajtua me siper nuk do te perdoret energji elektrike ne objekt.

- **Marrjen e masave per te eliminuar rrezigjet e ndotjes dhe krijimin e kushteve te favorshme ne instalim/impant, pas nderprerjes se funksionit te tij.**

Pas nderprerjes se punimeve ne kete objekt duhet te merren keto masa :

- Garantimi i demolimit te sigurve te objekteve te veprimtarise minerare te cilat nuk do te perdoren pas perfundimit te kesaj veprimtarie
- Realizimi i perfundimit te procesit te mbylljes me nje emetim sa me te vogel ne mjedis dhe garantimit te postmonitorimit minerar
- Bashkepunimi dhe veprimi i perbashket ndermjet autoriteteve te Qeverisjes Qendrore dhe asaj vendore
- Rehabilitimin e pjeseve te demtuara ne mjedis

j. Programi i vetemonitorimit te shkarkimeve ne mjedis (shtojca III)

Plani i monitorimit do te konsistoje ne :

- Monitorimin e parametrave gjeometrike te shkalleve te shfrytezimit si: pjerresi, lartesia, kendi i skarpates, pjerresia e sheshit te punes si dhe parametrave gjeometrike te parashikuar ne projekt.
- Monitorimi i sjelljes se shkembinjëve ne kufijte e jashtem te karrieres dhe marrja e masave per parandalimin e levizjeve te mundshme si shkarje, shembje ose vithisje Monitorimi i zones se mundshme te shperndarjes se pluhurit gjate aktivitetit te shfrytezimit.
- Monitorimi i parametrave fizike dhe dinamike te shperndarjes se pluhurit dhe marrja e masave perkatese te parashikuar ne projekt, per parandalimin e tij.
- Monitorimi i siperfaqeve te mbushura me material dhe toke vegjetale per parandalimin e shplarjeve, gryerjeve, krijimin e gropave etj. Atje ku evidentohen demtime te kesaj zone do te merren masa per riparimin e tyre.
- Monitorimi i siperfaqeve te mbjella, pemeve dhe bimeve te kultivuara, ecurise normale e mbirjes dhe zhvillimit te tyre. Ne rastet kur verehet se ka demtime merren masa per zevendesime me fidane te rinj. Monitorimi i çdo siperfaqe te mbjelle do te vazhdoje per nje periudhe 3 vjeçare, kohe gjate se ciles bimet kane marre nje zhvillim te konsiderueshem dhe nuk kane me nevojë per sherbime.

Subjekti merr persiper sigurimin e ecurise normale te punes dhe ruajtjen e vazhdueshme te mjedisit deri ne mbylljen e aktivitetit.

Subjekti, gjithashtu, do te kete lidhje te vazhdueshme me Agjensine Rajonale te Mjedisit, prane te se ciles do te informoje peridokisht per mbarvajtjen e punes si gjate shfrytezimit ashtu dhe per monitorimin e parametrave te me siper.

3, Programi i vetemonitorimit te shkarkimeve

Vendndodhja e monitorimit/Koordinatat

Parametri	Rezultatet (mg/l ose mg/m ³)				Metoda e marrjes se mostres	Qellimi / arsyeja e vleresimit analitik	Metoda analitike / teknika
	Janar	Prill	Korrik	Tetor			
Pluhura	Te paperfillshme				Me marrje kampioni	Rritjen e saktetise	Gravimetrike
Zhurma	50	50	50	50	Me aparature	Rritjen e saktetise	"Testo 815".

k. Plani i menaxhimit te mbetjeve ne perputhje me kerkesat e ligjit per menaxhimin e integruar te mbetjeve

Parimet baze per hartimin e planit te menaxhimit te mbetjeve minerare konsistojne ne :

Niveli i ndotjeve ne uje toke, flore dhe faune dhe ne ekosistem eshte parashikuar ne perputhje me vlerat minimale te pranuar sipas legjislacionit ne fuqi si per stoqet e depozitimit te mineralit dhe sterilit, shkarkimet ne ajer dhe shkarkimit te ujrave. Vendi ne te cilin do te kryhet depozitimi i mbetjeve eshte i sigurte, nuk perben asnje rrezik per mjedisin e komunitetit, si gjate kohes se shfrytezimit dhe pas shfrytezimit. Mbetjet minerare eshte parashikuar te trajtohen sipas karakteristikave te tyre, perberjes dhe dekompozimit. Menaxhimi i mbetjeve ne kete miniere eshte parashikuar qe te parandaloje ngjarjet aksidentale, te minimizojte dukurine efektive negative ne mjedis dhe te garantoje marrjen e masave efektive dhe me kosto te ulet. Projekti siguron dhe sugjeron monitorimin e vazhdueshem dhe informimin e hollesishem per punimet e kryera lidhur me depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve minerare. Rekomandohet shoqerise qe te gjitha veprimet qe lidhen me mjedisin te jene te koordinuara ndermjet autoriteteve te qeverisjes qendrore dhe vendore.

Mbetjet e krijuara mund te perdoren edhe per nevoja te komunitetit si shtrim rruges etj.. Mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti jetesor i punetoreve apo ambalazhet do te grumbullohen neper thase te posatshem dhe do te transportohen drejt drejt qendrave me te aferta te banuara per menaxhim nga sektoret perkates te pushtetit lokal. Gomat dhe vaji lubrifikant te perdoruar do t'u jepen subjekteve qe merren me riciklimin e tyre dhe qe aktualisht operojne edhe ne Shqiperi (Ministria e Mjedisit posedon nje liste te subjekteve riciklues).

2, Manaxhimi i mbetjeve

Material Mbetjesh	Vendi kryesor i germimit	Sasia		Trajtimi ose asgjесimi ne instalim/impiant (Metoda dhe vendndodhja)	Trajtimi, rikuperimi, riciklimi ose asgjесimi jashte instalimit / impiantit (Metoda, vendi, kontraktori)
		Ton/ muaj	m ³ / muaj		
Mbetje sterili	Ne kufijte e karieres	32-64	84-168	Sheshi i depozitimit te sterilit eshte parashikuar nen horizontin e fundit te shfrytezimit (kuota +540) me nje siperfaqe prej 110000 m ² . Ne kete shesh do te depozitohen edhe shkembenjte me carje dhe nderfutjet e sterileve ne mineral. I rekomandojme shoqerise qe pjesen e dobishme te mbuleses qe mund te perdoret per shtrim rruges rurale ta transportoje direkt per ne destinacion sipas kontratave te lidhura paraprakisht nga ana e saj	Nuk rikuperohen, riciklohen dhe asgjесohen.

I. Plani i rehabilitimit

Per rehabilitimin e siperfaqes qe do te shfrytezohet, rehabilitim shoqeria "Victoria Invest International " sh.p.k do te marre disa masa tekniko organizative dhe ka planifikuar te shpenzoje ne çdo vit mbi 1.000 000 leke. Me te detajuar keto leke do te shpenzohen bazuar ne masa per rehabilitimin e mjedisit si me poshte:

Masat per rehabilitimin e objektit hap pas hapi, krahas shfrytezimit konsistojne ne :

- Krijimin e siperfaqeve per mbledhje;
- Sistemimin e materialit te mbuleses te depozituar paraprkisht ne kufijte e karrieres;

Masat zbutese te ndikimeve negative gjate procesit te shfrytezimit

Masat zbutese te ndikimeve negative konsistojne ne marrjen e masave per uljen e ndotjeve gjate punimeve ne ajer, si pluhurat dhe zhurma, si dhe uljen e efekteve negative hapesinoredhe ne teritor ne faunen dhe floren. Per pikesynimi kryesor i studimit mbetet reabilitimi i tokes dhe evitimi ne maksimum i erozionit.

Masat konkrete qe do te merren gjate punimeve do te jene :

- Mbjellje me fidana pishe e gjithje periferise me te larte te shpatit te territorit gjate shfrytezimit. Kjo mase do te sherbeje edhe per uljen e nivelit te pluhurave dhe zhurmave ne vazhdim te projektit, si dhe te rrise mundesimin per vetegjenerim te drureve ne pjesen e lartme dhe shpatin tjetet te kodres.
- Uljen e tensionit te shfrytezimit per stinen e veres duke evituar keshtu me sa te jete e mundur erozionin dhe pluhurat. Nga ana tjetet per te ulur efektet erodike, gjate periudhave te thata do te perdoret lagja e terreneve nen pune dhe sidomos, lagja e vendburimit te materialit te nxjere. Kjo do te evitoje edhe ndotjen gjate transportit (materiali i thate krijon pluhura).

Rehabilitimi i territorit

Masat rehabilituese do te konsistojne ne :

- Uljen e erozionit
- Restaurimin e habitateve
- Pasurimin e biodiversitetit me speciet natyrore
- Rritjen e vlerave vizuale dhe rikrijuese te territorit qe do te shfrytezohet.

Se pari shfrytezimi me tarace me lartesi 2m, eshte bere per te lehtesuar zbatimin e planit te rehabilitimit. Keto taraca do te lejojne si mbulimin e siperfaqes me gjelberim ashtu edhe evitimin e pamjeve te pakendshme te shpateve vertikale te tarracave qe mund te mbeten zbuluar ne rastet e lartesis se pergjithshme te tarraces rreth 10m.

Rehabilitimi i tokes

Per rehabilitimin e tokes, do te shfrytezohen mbetjet e imeta nga materiali i nxjerre dhe do te plotesohet me 30 cm dhe' (toke) te pasur me pleh. Nese do te nevojitet stabilizimi i ketij dheu nje pjese te faqes se pjerret do te behet me trungje te ngulura ne toke me thellesi mbi 30 cm, dhe mulcirimi do te jete i thate dhe me kashte, gjrthe te bimeve te zones dhe dege. Mulcirimi do te sherbeje, si per uljen e humbjeve te farnave nga largimi prej aktivitetit eolik, ashtu dhe per uljen e aktivitetit erodikpersakohe vegetacioni eshte i pazhvilluar mire.

Mbjelljet do te kene renditjen me largesi fidanesh çdo 8 metra, gje qe do ti jape nje kurore dendesi mjaft te mire teritorit pas shfrytezimit, dhe lejon dritesimin per veterritjen dhe zhvillimin e bimeve natyrore.

Kombinimi i punimeve te shfrytezimit te gurores me ato te zbutjes se impakteve mjedisore si dhe punimet rehabilituese, do te kete si pasoje edhe rritjen e numrit te te punesuarve.

Kujdesi per punimet rehabilituese nga ana e shoqerise do te vazhdoje deri ne mbarimin perfundimtar te shfrytezimit te karieres.

Duke konsideruar sipërfaqet e shesheve që zene punimet e projektuara , në tabelen e meposhteme jepen shpenzimet e rehabilitimit:

Nr.	Operacioni	Siperfaqja	Normativa ha/ha	Sip. Operac. ha	Normativa m ³ /ha oper.	Volumi i punes (m ³)	Çmimi lek/njesi
I	Plani I mbylljes se karieres						
a	Krehje sistemim I faqeve anesore	1	1,5	1,5	200	300	50
II	Plani I menaxhimit te mbetjeve						
a	Sistemim I mbetjeve te zbulimit	1	0,6	0,6	2000	1200	20
b	Sistemim I mbetjeve teknologjike	1	0,25	0,25	2000	2000	20
III	Plani I rehabilitimit perfundimtar te mjedisit						
		Siperfaqja	Normativa ha/ha	Sip. Operac. ha	Normativa nr/ha	nr	Çmimi lek/njesi
a	Mbushje me dhe produktiv I sheshit fundor	1	0,5	0,5	2500	1250	35
b	Mbjellje pemesh	1	0,5	0,5	300	150	100
c	Hapje gropash	1	0,5	0,5	300	150	1000
d	Blerje pemesh	1	0,5	0,5	300	150	50
e	Sherbime	1	0,5	0,5	300	150	50
f	Kanali i ujrave te larta, drenazhim		Normativa ml/ha		Gjatesia ml		
		1	300		300	75	200
g	Sinjalistike						
j	Ngarkim materialesh		Sasia (ton)	Normativa ore/ton	Ore pune		Paga
			135	1	135		341

k	Transport materialesh, ngarkim, shkarkim	Sasia (ton)	Dist. Km	Çmimi l/ton/km		
		135	30	16		

Parashikohet sipas projektit qe zona qe do te shfrytezohet dhe do te rehabilitohet te kete nje siperfaqe prej rreth 720000 m² dhe jetegjatesia e karieres te jete 35 vjet. Vlera vjetore e garancise financiare per rehabilitimin e zones do te jete ;

584325 leke x 72 ha / 35 vjet = 1.202.040 lek / vit

- m. **Plani i perballimit te emergjencave dhe aksidenteve me pasoje ne mjedis per veprimtarite qe perdorin, prodhojne dhe depozitojne lende te rrezikshme per mjedisin dhe shendetin e njerezve**

Gjate gjithë periudhës ushtrimit të aktivitetit mineral në objekt nuk do të prodhohen, magazinohen apo depozitohen lende të rrezikshme, substance apo preparate të tjera të rrezikshme për mjedisin dhe shendetin e njerezve.

PERGATITI

"D.E.A. PROJEKT" SH.P.K.

Licensuar nga Q.K.L. për shërbime ekspertize profesionale lidhur me ndikimin në mjedis.

nr. license LN-4030-I I-2017

Ekspert Mjedisor:
Ing. Miniere:
Msc.Ing. Gjeomjedis:

Gezim DAUTI
Ardian BRAKO
Renald TOSKA